

Dhuna ne familje perfshin cfaredolloj forme abuzimi fizik, seksual, emocional ose financiar gjate ose pas nje raporti intim.

Nuk eshte faji juaj; sjellja abusive nuk eshte asnjehere e pranueshme.

Ne ju ofrojme mbeshtetje.

Komentet tuaja jane te mirepritura

Meqe Gjykata Specialiste per Dhunen ne Familje eshte nje iniciative e re, ne i mirepresim komentet dhe sugjerimet e juaja. Juve do t'ju kerkohet te plotesoni nje koment ne nje forme te Gjykates se Magjistratures per Londren Perendimore (West London Magistrates Court), per te ndihmuar Gjykatën dhe agjensite e perkrahjes qe te dine nese ato po i plotesojne nevojat tuaja.

Agjensia juaj e perkrahjes do te ishte e lumtur qe gjithashtu t'i kaloje Gjykates cfaredolloj ideje qe ju mund te keni per te permiresuar sherbimin tone.

Kontakte numrash telefoni ose agjensi perkrahese

Konfidenca eshte e sigurte per te gjitha keto sherbime.

Sherbimi i Deshmitareve: 020 8700 9342 ose 020 8700 9448

Nese ju jetoni ne Hammersmith dhe Fulham:

ADVANCE (sherbim keshillues): 020 7385 0409

Njesiti i Policise per Sigurine e Komunitetit : 020 8246 2880

Nese ju jetoni ne Kensington dhe Chelsea

Ndihma e Grave Eaves: 020 7373 8660

Perkrahja per Viktimen: 020 7259 2424

Njesiti i Policise per Sigurine e Komunitetit : 020 8246 0226

Ne rast urgjence ose shqetesimi :999

Gjykata Specialiste per Dhunen ne Familje

Ne Gjykatën e Magjistratës për Londrën Perendimore

Informacion per Viktimen/Deshmitaret

West London Magistrates Court
181 Talgarth Road London W6 8DN

Versioni 1,1 Mars 2003

Version March 2003 – Translated by CITAS June 2004

Gjykata Specialiste per Dhunen ne Familje ne Gjykatën e Magjistratures se Londres Perendimore

Nga Tetori 2002 e ketej, rastet e dhunes ne familje po trajtohen ne nje menyre tjetër ne Gjykatën e Magjistrateve te Londres Perendimore.

- **Nje Gjykate Specialiste per Dhunen ne Familje do te merret me shumicen e rasteve.**
- **Cdonjeri qe po merret me ceshtjen ne Gjykate ka marre pregatitje speciale mbi dhunen ne familje dhe cdo te thote ajo per viktimen/deshmitarin**
- **Jane paraqitur nje numer masash sigurie dhe perkrahjeje per t'ju ndihmuar ju qe te vini ne gjyq.**

Kjo fletushke eshte per t'ju ndihmuar ju qe te dini dhe te perdorni cka eshte ne dispozicion perpara, gjate dhe pas dates se gjyqit.

Perpara dates se gjyqit

Nese ju keni qene viktime e dhunes ne familje ju mund te kontaktoni ne cdo kohe perpara ose pas gjyqit, organizatat e dhena ne faqen e mbrapme. Ato mund t'ju ndihmojne ju me informacion, keshille dhe ceshtje te tjera praktike qe kane te bejne me sigurine tuaj. Pavaresisht faktit nese ju vendosni ose jo te na kontaktoni tani , ketu jane disa ide per te qene te sigurte dhe per te pergatitur veten per ne Gjyq.

Ju lutem vini re: Femijet nuk mund te sillen ne gjyq, keshtu qe organizoni dike te kujdeset per femijet tuaj.

Flisni me Sherbimin e Deshmitarit...

...per te rregulluar nje vizite ne gjyq (vizite para gjyqit) perpara dates se ceshtjes suaj per te pare se cfare ndodh, ku, dhe per te kontrolluar ose kerkuar masa sigurie per ditën e gjyqit, psh. ju mund te organizoni qe te hyni dhe te largoheni nga ndertesa a gjykates nepermjet nje dëre te vecante nese ju jeni i/e shqetesuar persa i perket takimit me partnerin /ish partnerin tuaj;

...Nese jeni i paafte fizikisht dhe keni nevojë per parkim per invalidet ne gjyq, ose per te organizuar ndihme per te hyre ne ndertese.

Flisni me policine...

...nese keni nevojë që një perkthyes i gjuhës ose perkthyes britanik i shenjave (British Sign Language) të jetë i pranishëm për një vizitë para ose gjatë gjyqit për t'ju asistuar si deshmitar.

...sa më parë për një fletë udhëtimi (bono për shpenzimet) për të mbuluar shpenzimet e transportit publik për ne gjyq vajtje- ardhje. Nëse ju nuk ndiheni i sigurtë me transportin publik, flisni me policinë- ka mundësi të rregullohet një mënyrë tjetër për të ardhur në gjyq;

...rreth çdo veprimi tjetër ligjor që ka lidhje me dhunen në familje psh. urdher për mos-shqetesim, ose procedura për të kontaktuar femijën;

...menjehere rreth ndonjë shqetesimi, kercenimi ose rreziku, ose nëse pikat e lirimit me kusht apo urdheresat civile janë shkelur nga partneri/ish partneri juaj.

Shpenzimet në ditën e gjyqit

Ju mund të bëni kërkesë për shpenzimet e udhëtimit dhe shpenzime të tjera dhe për shumën e parave baraz me ato që mund të kishit fituar atë ditë. Mbani të gjitha faturat. Ju duhet t'ju jetë derguar me postë një fletë kërkesë nga policia, nëse jo, ju lutem i thoni prokurorit.

Ne ditën që do të shkoni në gjyq

- Ju mund të sillni një shok/shoqe për të pritur bashkë me ju.
- Merrni disa të holla për të blerë ushqim dhe pije.
- Mundohuni të arrini pak më herët se ç'duhet.
- Kur të arrini, i thoni personit në recepsion që jeni deshmitar për Gykatën Specialiste të Dhunës në Familje.
- Ju do t'ju takojë një nepunës nga Sherbimi i Deshmitareve (rezidentet e Kensington-it dhe Chelsea-it) ose ADVANCE (rezidentet e Hammersmith-it dhe Fulham-it), që do t'ju pershkruajnë se çfarë do të ndodhë dhe do të qëndrojnë me ju.
- Ju do t'ju çojnë në një sallë pritjeje larg nga i akuzuari.
- Nëse keni kërkuar perkthyes, do të prezantoheni me të.

Ne Gjyq

Kur te hyni ne sallën e gjyqit edhe per krahesi juaj nga Sherbimi i Deshmitareve ose ADVANCE, do te jene aty me ju. Ju do t'ju drejtojne per ne banken e deshmitarit dhe do t'ju behen pyetje nga prokuroria dhe pala mbrojtese ne lidhje me cfare ju ka ndodhur. Pasi te keni dhene deshmine tuaj, do t'ju thuhet se mund te largoheni nga gjyqi.

Gjykatesit do te degjojne te gjithë evidencen(psh. nga policia, deshmitaret, evidencen mjekesore) dhe do te vendosin nese personi i akuzuar per dhune ndaj jush eshte apo jo fajtor. Nese personi i akuzuar gjendet fajtor, gjykatesit vendosim ndeshkimin(denimin)

Pas gjyqit

Ju do te kontaktoheni sa me shpejt qe te jete e mundur nga policia dhe/ose agjensia e perkrahjes rreth vendimit te gjyqit.

Ata gjithashtu do t'ju japin cdo lloj informacioni qe keni nevojë per t'ju ndihmuar ju te mendoni rreth mundesive qe keni dhe t'ju mbeshtesin kur t'i zgjidhni keto opsione.

Agjensia juaj e perkrahjes mund t'ju ndihmoje te beni kerkese per urdher mbrojtjeje (Urdher Mos Bezdisjeje) nese nuk e keni akoma nje te tille.

Nese ju kercenoheni apo bezdiseni ne cfaredo menyre nga partneri apo ish-partneri juaj, pas vendimit te gjyqit, ju duhet te kontaktoni menjehere policine ose agjensine tuaj te perkrahjes.